

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Menaxhment Financiar
(zgjidhjet)

P7

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT

Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.

2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA
PYETJEVE

All Questions Are Mandatory

3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË

Time Allowed is 3 Hours

4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.

Your name should appear nowhere in this test

Data: 17.07.2021

Problemi 1

a) Jepni 5 shembuj të ndryshoreve (variablove) të pasigurta e të pavarura prej të cilave mund të varet Vlera e Tanishme Neto / NPV - ja e një projekti? **(10 pikë)**

b) Identifikoni 4 arsye se pse një kompani mund të kërkojë të regjistrohet në një bursë të këmbimit të aksioneve dhe të letrave me vlerë? **(5 pikë)**

c) Aksionet e kompanisë kanë një vlerë nominale prej € 1 dhe një vlerë të tregut prej € 3. Në një emetim për të drejtat, një aksion i ri do të emetohet për çdo tre aksione me një çmim prej € 2.60. Cili është çmimi teorik për ex - të drejtat? **(5 pikë)**

d) Për çfarë arsyeje mund të preferojnë aksionarët një dividend tani në vend të një fitimi kapital në të ardhmen? **(5 pikë)**

(Total: 25 pikë)

(a)

5 shembuj të ndryshoreve (variabla) të pasigurta e të pavarura prej të cilave mund të varet Vlera e Tanishme Neto / NPV – ja e një projekti:

(a) Çmimi i shitjes (variabël e pavarur dhe ndikuese e drejtëpëdrejtë në VTN/NPV)

(b) Vëllimi i shitjes (variabël e pavarur dhe ndikuese e drejtëpëdrejtë në VTN/NPV)

(c) Kostoja e kapitalit (variabël e pavarur dhe ndikuese e drejtëpëdrejtë në VTN/NPV)

(d) Kostoja fillestare (variabël e pavarur dhe ndikuese e drejtëpëdrejtë në VTN/NPV)

(e) Kostot operacionale (variabël e pavarur dhe ndikuese e drejtëpëdrejtë në VTN/NPV)

(f) Përfitimet (variabël e pavarur dhe ndikuese e drejtëpëdrejtë në VTN/NPV)

(b)

Katër prej pesë të mëposhtmeve: qasja ndaj një spektri më të gjerë të financimit; tregtueshmëri e përmirësuar e aksioneve; transferimi i kapitalit ndaj përdorimeve të tjera (p. sh. kthimi në pasuri likuide i pjesëve të aksionarëve themelues); mbarështimi i imazhit të kompanisë; mundësia rritjes së biznesit me anë të blerjeve/bashimeve.

(c)

$$\frac{1}{3+1} ((€ 3 \times 3) + € 2.60) = € 2.90$$

(d)

Përparësitë tatimore ose për arsye se fitimet kapitale në të ardhmen me mundësi të madhe do të jenë të pasigurta

Problemi 2

(pjesa 1) Kompania ABC prodhon produkte elektrike për përdorim në amvisëri. Ajo përdor modelin e SPE për të bërë vendimmarrje lidhur me menaxhimin e stokeve të lëndëve të para për produktet e saja. Ajo po merr në konsideratë vendimmarrjen lidhur me stoqet e Produktit X. Ky është një produkt shumë i kërkuar në treg. Të dhënat për vitin 2016 janë si më poshtë:

Kërkesa e pritshme vjetore për produktin X 22,500 copë

Kostoja e porositjes për porosi të blerjes €162

Kostoja vjetore e mbajtjes €9 për njësi

Koha e përmbushjes së porosisë është 12 ditë

Kërkohet

- a. Duke supozuar se Kompania ABC punon 250 ditë në vit
 - i. Të llogaritet SPE. 3 pikë
 - ii. Të llogaritet numri i porosive që do të bëhet brenda vitit. 3 pikë
 - iii. Të llogaritet totali i kostove të stokeve (kostos e porositjes dhe të mbajtjes) 2 pikë
 - iv. Të llogaritet niveli i porosisë së re. 2 pikë

(Pjesa 2) Kohët e fundit furnitori kryesor i kompanisë ka instaluar softuerin kompjuterik që u mundëson klientëve të saj të bëjnë porositë e lëndës së parë on-line. Duke përdorur këtë teknologji kostoja e bërjes së porosisë së blerjes do të reduktohet në vetëm €50 për porosi.

Kërkohet

- b. Duke supozuar se të gjitha të dhënat tjera mbesin të njëjta
 - i. Të llogaritet SPE. 3 pikë
 - ii. Të llogaritet numri i porosive që do të bëhet brenda vitit. 3 pikë
 - iii. Të llogaritet totali i kostove të stokeve (kostos e porositjes dhe të mbajtjes) 3 pikë
- c. Diskutoni arsyet tradicionale për mbajtjen e stokeve. 3 pikë
- d. Shpjegoni se si stoqet e sigurisë përdoren për t'u përballur me pasigurinë e kërkesës. 3 pikë

(Totali 25 pikë)

Formula

$$SPE = \sqrt{\frac{2DP}{C}}, \text{ ku}$$

D = Kërkesa e pritshme vjetore

P = Kostoja e porositjes

C = Kostoja vjetore e mbajtjes për njësi

Zgjidhja e problemi 2

a.i. Llogaritja e SPE

$$D = 22,500 \text{ njësi}$$

$$P = €162$$

$$C = €9 \text{ për njësi}$$

$$\text{SPE} = \sqrt{\frac{2DP}{C}} = \sqrt{\frac{2 \times 22,500 \times €162}{€9}} = \sqrt{\frac{7,290,000}{€9}} = \sqrt{810,000} = \underline{900} \text{ njësi}$$

a.ii. Llogaritja e numrit të porosive brenda vitit

$$\begin{aligned} \text{Numri i porosive} &= \text{Kërkesa e pritshme vjetore} \div \text{Numri i njësive të SPE} \\ &= 22,500 \text{ njësi} \div 900 \text{ njësi} \\ &= \underline{25} \text{ porosi} \end{aligned}$$

a.iii. Llogaritja e kostove totale të stoqeve (kostove të porositjes dhe të mbajtjes)

$$\begin{aligned} \text{Kostot totale të stoqeve} &= (PD/Q) + (CQ/2) \\ &= [(\€162 \times 22,500) / 900] + [(\€9 \times 900) / 2] \\ &= (\€3,645,000 \div 900) + (\€8,100 \div 2) \\ &= \€4,050 + \€4,050 \\ &= \underline{\€8,100} \end{aligned}$$

a.iv. Llogaritja e nivelit të porosisë së re

$$\begin{aligned} \text{Kërkesa ditore} &= \text{Kërkesa e pritshme vjetore} \div \text{numri i ditëve të punës} \\ &= 22,500 \text{ njësi} \div 250 \text{ ditë} \\ &= \underline{90} \text{ njësi për ditë punë} \end{aligned}$$

Koha e përmbushjes së porosisë **12** ditë

$$\begin{aligned} \text{Niveli i porosisë së re} &= \text{Numri i njësive për ditë pune} \times \text{Koha e përmbushjes së porosisë} \\ &= 90 \text{ njësi} \times 12 \text{ ditë} \\ &= \underline{1,080} \text{ njësi} \end{aligned}$$

b.i. Llogaritja e SPE

$$D = 22,500 \text{ njësi}$$

$$P = €50$$

$$C = €9 \text{ për njësi}$$

$$\text{SPE} = \sqrt{\frac{2\text{DP}}{C}} = \sqrt{\frac{2 \times 22,500 \times \text{€}50}{\text{€}9}} = \sqrt{\frac{2,250,000}{\text{€}9}} = \sqrt{250,000} = \underline{500} \text{ njësi}$$

b.ii. Llogaritja e numrit të porosive brenda vitit

$$\begin{aligned} \text{Numri i porosive} &= \text{Kërkesa e pritshme vjetore} \div \text{Numri i njësive të SPE} \\ &= 22,500 \text{ njësi} \div 500 \text{ njësi} \\ &= \underline{45} \text{ porosi} \end{aligned}$$

b.iii. Llogaritja e kostove totale të stoqeve (kostove të porositjes dhe të mbajtjes)

$$\begin{aligned} \text{Kostot totale të stoqeve} &= (\text{PD}/\text{Q}) + (\text{CQ}/2) \\ &= [(\text{€}50 \times 22,500) / 500] + [(\text{€}9 \times 500) / 2] \\ &= (\text{€}1,125,000 \div 500) + (\text{€}4,500 \div 2) \\ &= \text{€}2,250 + \text{€}2,250 \\ &= \underline{\text{€}4,500} \end{aligned}$$

c. Arsyet tradicionale për mbajtjen e stoqeve:

- i. për të balancuar kostot e porosive ose përgatitjes dhe kostot e mbajtjes;
- ii. pasiguria e kërkesës;
- iii. defektet e makinerisë;
- iv. pjesët me defekt;
- v. pjesët që nuk janë të gatshme;
- vi. dërgesa e vonuar e pjesëve;
- vii. proceset e pasigurta të prodhimit;
- viii. për të përfituar të zbritjet (uljet) e çmimeve;
- ix. për t'u mbrojtur nga rritjet e ardhshme të çmimeve.

d. Stoqet e sigurisë janë stoqe shtesë që mbahen për të shërbyer si një sigurim ndaj luhatjeve të kërkesës. Stoqet e sigurisë llogariten duke shumëzuar kohën e përcaktuar për përmbushjen e porosisë me ndryshimin midis normës maksimale të përdorimit dhe normës mesatare të përdorimit.

Problemi 3

ABC Kompania është duke planifikuar një investim prej €380,000 për një vinç. Vinçi pritet të operojë 2,000 orë në vit për pesë vjet. Kompanitë ndërtimore do të paguajnë €220 në orë për përdorimin e vinçit. Kostoja e operatorit të vinçit është €60 në orë. Kostoja vjetore e mirëmbajtjes së vinçit pritet të jetë €14,600. Kostot tjera operative pritet të jenë €80 për orë të aktivitetit të vinçit.

Kërkohe:

- Të përcaktohen neto rrjedhjet e barabarta vjetore të parasë nga aktiviteti i vinçit. **5 pikë**
- Të përcaktohet vlera e tanishme neto e investimit, duke supozuar se norma e dëshiruar e kthimit është 12%. **3 pikë**
- A duhet Kompania ABC të investojë në vinç, bazuar në këtë analizë? **2 pikë**
- Përcaktoni numrin e orëve të operimit të vinçit në vit në mënyrë që vlera aktuale e rrjedhjeve të parasë të jetë e barabartë me shumën që do të investohet. **Ndihmesë:** Problemi për të zgjidhur mund të shprehet si më poshtë: **5 pikë**

$$(df) \times [(Çmimi\ i\ përdorimit\ \times\ orët) - (Kostoja\ e\ operatorit\ \times\ orët) - (Kostot\ tjera\ operative\ \times\ orët) - Kostot\ e\ mirëmbajtjes] = Vlera\ e\ investimit$$
 ku, (df) është faktori skontues
- Shpjegoni përse metoda e zhvlerësimit të përshpejtuar për njohjen e zhvlerësimit është më e mirë se sa metoda drejtvizore të zhvlerësimit (në kontekstin e Vlerës Neto të Tanishme). **5 pikë**
- Çfarë është periudha e kthimit (*shlyerjes në vite/ri-pagimit*)? Tregoni dhe diskutoni arsyet e mundshme ku periudha e kthimit (*shlyerjes në vite/ri-pagimit*) përdoret për të ndihmuar në marrjen e vendimeve për investimin e kapitalit. Cilat janë *disavantazhet*? **5 pikë**

Vlera e tanishme e anuitetit të zakonshme të €1 për periudhë										
	2.00%	4.00%	6.00%	8.00%	10.00%	12.00%	14.00%	16.00%	18.00%	20.00%
1	0.980	0.962	0.943	0.926	0.909	0.893	0.877	0.862	0.847	0.833
2	1.942	1.886	1.833	1.783	1.736	1.690	1.647	1.605	1.566	1.528
3	2.884	2.775	2.673	2.577	2.487	2.402	2.322	2.246	2.174	2.106
4	3.808	3.630	3.465	3.312	3.170	3.037	2.914	2.798	2.690	2.589
5	4.713	4.452	4.212	3.993	3.791	3.605	3.433	3.274	3.127	2.991
6	5.601	5.242	4.917	4.623	4.355	4.111	3.889	3.685	3.498	3.326
7	6.472	6.002	5.582	5.206	4.868	4.564	4.288	4.039	3.812	3.605
8	7.325	6.733	6.210	5.747	5.335	4.968	4.639	4.344	4.078	3.837
9	8.162	7.435	6.802	6.247	5.759	5.328	4.946	4.607	4.303	4.031
10	8.983	8.111	7.360	6.710	6.145	5.650	5.216	4.833	4.494	4.192

(Totali: 25 pikë)

Zgjidhja e problemi 3

- a. Përcaktimi i neto rrjedhjeve të barabarta vjetore të parasë nga aktiviteti i vinçit

	<u>Orë të punës</u>	<u>Çmimi/kosto</u>	<u>Vlera</u>	<u>Totali</u>
<u>Rrjedhjet hyrëse të parasë</u>				
Aktiviteti i vinçit	2,000	€220		€440,000
<u>Rrjedhjet dalëse të parasë</u>				
Kostoja e operatorit (manipuluesit)	2,000	€60	€120,000	
Kostot tjera operative	2,000	€80	€160,000	
Kostot e mirëmbajtjes			€14,600	€294,600
Rrjedhjet neto të parasë				€145,400

- b. Vlera e tanishme neto e investimit, më normë të dëshiruar të kthimit prej 12%

	<u>Vlera</u>	<u>Faktori skontues (df)</u>	<u>Vlera e tanishme</u>
Rrjedhja dalëse të parasë	€380,000	1.000	€380,000
Rrjedhjet hyrëse të parasë	€145,500	3,605	€524,167
VTN e rrjedhjeve të parasë			€144,167

- c. Bazuar në analizën e mësipërme Kompania ABC duhet të bëjë investimin në vinç, për arsye se kostoja e investimit në vinç është më pak se vlera e tanishme e rrjedhjeve hyrëse të parasë sipas normës së dëshiruar të kthimit prej 12%, respektivisht Kompania ABC ka vlerë të tanishme neto pozitive në vlerë prej €144,167.

- d. Përcaktimi i numrit të orëve vjetore të operimit të vinçit për të barazuar shumën që do të investohet.

Si ndihmesë është paraqitur problemi që duhet të zgjidhet për gjetjen e numrit të orëve:

$$(df) \times [(Çmimi i përdorimit \times orët) - (Kostoja e operatorit \times orët) - (Kostot tjera operative \times orët) - Kostot e mirëmbajtjes] = Vlera e investimit$$

Le të jetë Y = numri i orëve, atëherë:

$$3.605 \times (€220 Y - €60 Y - €80 Y - €14,600) = €380,000$$

$$3.605 \times [(€220 - €60 - €80) Y] - (3.605 \times 14,600) = €380,000$$

$$(3.605 \times €80 Y) - €52,633 = €380,000$$

$$288.40 Y = €380,000 + €52,633$$

$$Y = €432,633 \div 288.40$$

$$Y = 1,500 \text{ orë (të rrumbullakuara) pune të vinçit në vit.}$$

- e. Metoda e zhvlerësimit të përshpejtuar ofron shpenzim të zhvlerësimit (shpenzim jo-monetar) më të lartë në vitet e para të jetës së përdorimit të projektit krahasuar me metodën drejtvizore të zhvlerësimit. Meqenëse zhvlerësimi i pretenduar në vitet e para të një projekti është më i madh, kursimet e tatimeve janë më të mëdha gjatë atyre viteve. Duke konsideruar

vlerën në kohë të parasë, është më e preferueshme që të kemi kursime tatimesh më herët se sa më vonë. Për këtë, firmat e preferojnë më shumë metodën e tillë të zhvlerësimit kundrejt metodës drejtvizore të zhvlerësimit.

- f. Periudha e kthimit është metodë jo-zbritëse/skontuese (që nuk merr parasysh vlerën e parasë në kohë) e cila përdoret për marrjen e vendimeve për investime kapitale. Periudha e kthimit është koha që kërkohet për një firmë që të rikthejë investimin e saj origjinal.

Periudha e kthimit përdoret për këto arsye:

- Periudha e kthimit mund të përdoret si një *masë e papërpunuar risku*, me mendimin se sa më shumë i duhet një projekti për të paguar për vetën e tij, aq me shumë risk mban ai.
- Arsye tjetër e rëndësishme është *vjetrimi*. Në disa industri risku i vjetrimit është i lartë; firmat brenda këtyre industrive do të jenë të interesuara në rikthimin sa më të shpejtë të fondeve.
- Arsye tjetër, me më pak përfitim për firmën, mund të jetë i lidhur me *interesat vetanake të menaxherëve vendimmarrës për investime kapitale*. Shumë menaxherë në një pozitë për të marrë vendime për investime të kapitalit mund të zgjedhin investime me periudha të shpejta kthimi për arsye të interesave vetanake, duke rritur kështu shanset për bonuset dhe ngritje në pozitë.
- Mund të përdoret për të *zgjedhur midis alternativave konkurruese*. Sipas kësaj metode, investimi me periudhë të kthimit më të shkurtër është më i preferuar ndaj investimit me periudhë kthimi më të gjatë.

Disavantazhet e periudhës së kthimit:

- injoron performancën e investimeve përtej periudhës së kthimit;
- injoron vlerën në kohë të parasë.

Problemi 4

Pasuritë qarkulluese dhe Detyrimet afatshkurtra të ABC në fund të marsit 2019, janë si në vijim:

	€000	€000
Stoqet	5,700	
Të arkëtueshmet tregtare	6,575	12,275

Të pagueshmet tregtare	2,137	
Overdrafti (mbitërheqja)	4,682	6,819
	-----	-----
Pasuritë neto afatshkurtra		5,456

Për vitin që përfundon në mars 2019, ABC kishte shitje vendore dhe jashtë vendit prej €40 milionë, që të gjitha me afat pagese, përderisa kostoja e shitjes ishte €26 milionë. Llogari të pagueshme tregtare që kanë të bëjnë me furnizimet vendore dhe jashtë vendit.

Për vitin që përfundon në mars 2020, ABC ka parashikuar që shitjet me afat pagese do të mbesin €40 milion, ndërsa kostoja e shitjes do të zvogëlohet në 60% të shitjeve. Kompania pret që pasuritë qarkulluese do të përbëhen nga stoqet dhe llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe detyrimet afatshkurtra do të përbëhen nga llogaritë e pagueshme tregtare dhe overdrafti (mbitërheqja bankare) i kompanisë.

ABC gjithashtu planifikon të arrijë objektivin e mëposhtëm për vlerat e koeficientëve të kapitalit punues për vitin që përfundon në mars 2020:

Ditët e stoqeve:	60 ditë
Ditët e të arkëtueshmeve tregtare:	75 ditë
Ditët e të pagueshmeve tregtare:	55 ditë
Koeficienti qarkullues:	1.4 herë

Kërkohet:

- (a) Kalkuloni ciklin e kapitalit punues (ciklin e parasë së gatshme) të ABC në fund të marsit 2019 dhe diskutoni nëse cikli i kapitalit punues duhet të jetë pozitiv apo negativ. **(6 pikë)**
- (b) Kalkuloni koeficientin e shpejtë (koeficientin e testit acid) dhe koeficientin e synuar të shitjeve të kapitalit punues neto të ABC në fund të marsit 2020. **(5 pikë)**
- (c) Analizoni dhe krahasoni gjendjet e pasurive qarkulluese dhe detyrimeve afatshkurtra për mars 2019 dhe mars 2020 dhe diskutoni se si do të mund të ndryshonte politika financiare e kapitalit punues të ABC. **(8 pikë)**
- (d) Diskutoni shkurtimisht TRE metoda të brendshme të cilat do të mund të përdoren nga ABC ndaj rrezikut të transaksionit që rrjedh nga aktivitetet e saja të vazhdueshme të biznesit. **(6 pikë)**

(Totali = 25 pikë)

Zgjidhje e problemit - 4

a)

Ditët e inventarit = $365 \times (5,700/26,000) = 80$ ditë

Ditët e të arkëtueshmeve tregtare = $365 \times (6,575/40,000) = 60$ ditë

Ditët e të pagueshmeve tregtare = $365 \times (2,137/26,000) = 30$ ditë

Cikli i kapitalit punues i ABC = $80 + 60 - 30 = 110$ ditë

Cikli i kapitalit punues i ABC është pozitiv dhe ndërmarrja paguan furnizuesit e saj tregtar 110 ditë (në mesatare) para së të pranojë të hollat prej konsumatorëve të saj. Kjo përfaqëson nevojën për financimin aq sa ABC është e shqetësuar, i cili mund të financohet nga burimet afatshkurtra dhe afatgjata.

Nëse cikli i kapitalit punues do të ishte negativ, ABC do të ishte duke pranuar para nga konsumatorët e saj përpara se të ishte e nevojshme të paguante furnitorët e saj tregtar. Ndërmarrja e cila nuk iu ofron afat pagese konsumatorëve të saj, të tilla si zinxhiri i supermarketeve, mund të ketë një cikël negativ të kapitalit punues.

Edhe në qoftë se kompanitë në përgjithësi preferojnë të paguhen nga konsumatorët para se të paguajnë furnitorët e tyre, çështja nëse cikli i kapitalit punues duhet të jetë pozitiv apo negativ nënkupton se kompanitë janë në gjendje të bëjnë një zgjidhje të tillë, por ky nuk është zakonisht rasti. Kjo është si rezultat i asaj se gjatësia e ciklit të kapitalit punues varet nga elementet e tij, e që janë: ditët e inventarit, ditët e të arkëtueshmeve tregtare dhe të pagueshmeve tregtare dhe këto elemente zakonisht varen nga natyra e biznesit me të cilën afaron kompania dhe mënyra se si biznesi zhvillohet nga konkurrentët e saj. Për këtë arsye, gjatësia e ciklit të kapitalit është zakonisht i ngjashëm në mes të kompanive në sektorin e njëjtë të biznesit, por mund të ndryshojë ndërmjet sektorëve të biznesit.

b)

Në fund të marsit 2020:

Kosto e shitjeve = $40,000,000 \times 0.6 = €24,000,000$

Inventari duke përdorur ditët e synuara të inventarit = $24,000,000 \times 60/365 = €3,945,206$

Të arkëtueshmet tregtare duke përdorur ditët e synuara të të arkëtueshmeve tregtare = $40,000,000 \times 75/365 = €8,219,178$

Pasuritë qarkulluese = $3,945,206 + 8,219,178 = €12,164,384$

Nëse koeficienti aktual i synuar është 1.4 herë, Detyrimet afatshkurtra = $12,164,384/1.4 = €8,688,846$

Koeficienti i shpejtë i synuar (Koeficienti i testit acid) = $8,219,178/8,688,846 = 0.95$ herë

Pasuritë qarkulluese neto në fund të marsit 2020 = $12,164,384 - 8,688,846 = €3,475,538$

Koeficienti shitjet e synuara/neto kapitali punues = $40,000,000/3,475,538 = 11.5$ herë

c)

Detyrimet afatshkurtra në fund të marsit 2020, të kalkuluara në pjesën (b) mund të ndahet në të pagueshmet tregtare dhe gjandja e overdraftit të parashikuar.

Të pagueshmet tregtare duke përdorur ditët e synuara të të pagueshmeve tregtare = $24,000,000 \times 55/365 = €3,616,438$.

Overdrafti (figurë balancuese) = $8,688,846 - 3,616,438 = €5,072,408$

Krahasimi i pasurive qarkulluese dhe detyrimeve afatshkurtra:

	Mars 2019		Mars 2020	
	€000	€000	€000	€000
Stoqet	5,700		3,945	
Të arkëtueshmet tregtare	6,575	12,275	8,219	12,164
Të pagueshmet tregtare	2,137		3,616	
Overdrafti	4,682	6,819	5,072	8,688
Pasuritë neto qarkulluese		5,456		3,476

Overdrafti si përqindje e detyrimeve afatshkurtra do të bie nga 69% (4,682/6,819) në 58% (5,072/8,688). Edhe pse overdrafti pritet të rritet me 8.3%, detyrimet afatshkurtra pritet të rriten me 27.4% (8,688/6,819). Shumica e kësaj rritjeje pritet të realizohet nga të pagueshmet tregtare, të cilat do të rriten me 69.2% (3,616/2,137) dhe rritje të ditëve të të pagueshmeve tregtare nga 30 ditë në 55 ditë.

Në fund të marsit 2014, detyrimet afatshkurtra ishin 56% e pasurive qarkulluese (100 x 6,819/12,275), duke bërë të ditur se 44% të pasurive qarkulluese ishin financuar nga burimet afatgjata. Në fund të marsit 2015, detyrimet afatshkurtra pritet të jenë 71% të pasurive qarkulluese (100 x 8,688/12,164), duke sugjeruar se 29% e pasurive qarkulluese janë financuar nga burimet afatgjata. Kjo varësi në rritje të financimeve afatshkurtra nënkupton një ndryshim agresiv në politikat e financimit të kapitalit punues të ABC.

d)

Rreziku i transaksioneve lidhet me transaksionet në valutë të huaj të cilat janë të natyrës afatshkurtër, të tilla si pagesat e pritura nga kompania nga të arkëtueshmet tregtare të jashtme, pagesat e bëra nga kompania ndaj të pagueshmeve tregtare të jashtme dhe pagesat e interesit të bëra nga kompania për borxhin në valutë të huaj. Rreziku i transaksioneve mund të menaxhohet nga disa metoda të brendshme.

Valuta e faturës

Një e brendshme mbrojtëse është që kompania të faturojë konsumatorët jashtë vendit në valutën e saj vendase, duke e transferuar rrezikun e valutës së huaj tek konsumatorët jashtë vendit. Kjo metodë zakonisht nuk është e zbatueshme nga ana tregtare, megjithatë, meqenëse konsumatorët do të transferojnë biznesin e tyre tek konkurrentët të cilët bëjnë faturime në valutë të huaj, si rezultat i kësaj do të shmangin rrezikun e valutës së huaj.

Bashkërendimi

Rreziku nga pranimet dhe pagesat në valutë të huaj mund të menaxhohet me bashkërendim. Pranimet dhe pagesat në të njëjtën valutë të huaj mund të bashkërendohen, për shembull, duke

përdorur llogarinë bankare në valutë të huaj, kështu që nuk është nevoja të blihet valuta e huaj. Në një pamje afatgjatë, pasuritë dhe detyrimet mund të bashkërendohen me qëllim të mbrojtjes nga rreziku në valutë të huaj. Për shembull, kompania e cila pret të hyra të rregullta në valutë të huaj mund të përdorë borxhin të cilin e ka në të njëjtën valutë për të plotësuar një nevojë për financim, në mënyrë që interesi në valutë të huaj i borxhit mund të bashkërendohet me të ardhurat nga valuta e huaj.

Udhëheqje dhe ngecje

Rreziku i transaksioneve mund të menaxhohet nga udhëheqja dhe ngecja, ku pagesat në valutë të huaj mund të bëhen në avancë (prijës) ose me vonesë (ngecje), varësisht nga pikëpamja e kompanisë për sa i përket asaj nëse valuta e pagesave pritet të mbivlerësohet apo të nënvlerësohet kundrejt valutës vendase. Megjithatë, pagesat me vonesë tek llogaritë e pagueshme nuk duhet të tejkalojnë periudhën e kredisë të dakorduar me furnizuesin.